



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKAKOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi Prilipi / Protokoli Receipt / Delivery	17.01.2022	2	viti and year
Organ / Shërbimi Org / Unit	SKAMSHICK	190/2022	115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.1187/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar, Zyle Millaku-Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.3032/19 të datës 13.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën e ankuesit të datës 08.07.2019 me numër A.nr.382/2021, me adresë: Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike “**kontestim konkursi**”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.01.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.382/2019 e datës 08.07.2019 e parashtruar nga ankuesi

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi me numër protokoli 01-111/01-0045654-2/19, të datës 26.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës.

**A r s y e t i m**

Komuna e Mitrovicës, pasi që ka marrë autorizimin e datës 15.03.2019 nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, për miratimin e shpalljes së konkursi të jashtëm për pozitën: SHFMU “Abdullah Shabani” me datë 20.03.2019 ka shpallur konkursin për pozitën e lartshënuar. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili ka marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (listën e shkurtër, intervistën me gojë), ndërsa më datë 15.05.2019 ankuesi është njoftuar për përzgjedhjen përfundimtare nga Menaxheri i Personelit në Komunën të Mitrovicës.

Ankuesi, kundër njoftimit të datës 15.05.2019 ka parashtruar ankesë me datë 30.05.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunë e Mitrovicës, me nr. Protokoli 01-111/01-0045654-2/19.



Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunë të Mitrovicës, më datë 26.06.2019 ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 01-111/01-0045654-2/19, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit. Ankuesi kundër Vendimit me numër 01-111/01-0045654-2/19 të datës 26.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunë të Mitrovicës, me datë 08.07.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 3060/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.07.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Mitrovicës e cila me datë 01.08.2019, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 26.08.2019. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, e cila me datë 13.12.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.3032/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 26.08.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 08.07.2019.

**Administrimi i provave**-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykim A.nr.3032/19 i datë 13.12.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën A.Nr.386/2019 të datës 08.07.2019 me numër te protokollit 3060/2019, të dërguar dhe me datë 09.07.2019 nr. protokollit 3074/19 për mes postës elektronike [ankesa.kpmshek@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshek@rks-gov.net), duke bashkangjitur CD; Kërkesë për urgjencë e datës 15.01.2021; Vendimi me numër protokollit 01-111/01-0045654-2/19, të datës 26.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës; Fotografii të anëtarëve të komisionit; Deklaratë e ankuesit e datës 15.05.2019; Certifikatë e lëshuar nga GIZ në bashkëpunim me MASHT-të, në programin, Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për përmasimin e qeverisjes, menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës, 84 orë praktike dhe njëzet e një orë monitoruese gjithsej 231 orë për certifikim; Certifikatë "Menaxhim dhe Udhëheqje", lëshuar nga EU; Certifikatë "Udhëheqje në arsim", lëshuar nga KEDP; Certifikatë "Monitorimi i mësimdhënies (40 orë) , lëshuar nga KEC"; Certifikatë "Edukim për të drejtat e fëmijëve" (32 orë) e lëshuar nga KEC; Certifikatë e lëshuar nga MASHT-të; Certifikatë "Plani zhvillimor i shkollës(24 orë), i lëshuar nga KEC; Certifikatë e lëshuar nga UNMIK; Certifikatë "Plani i projekteve shkollore(16 orë), i lëshuar nga KEC; Certifikatë "Avokim për politika (16 orë), i lëshuar nga KEC; Certifikatë i lëshuar nga QPEA; Certifikatë i lëshuar nga EU; Certifikatë i lëshuar nga MASHT; Mirënjohje e SBASHK-së i datës 07.03.1996; Mirënjohje e datës 12.06.2011; Mirënjohje e datës 27.12.2017; Mirënjohje e datës 22.04.2011 lëshuar nga Këshilli i prindërve; Mirënjohje e datës 28.05.2009; Mirënjohje e datës 10.05.2017; Falënderim i datës 22.01.2007 nga SHFMU "Abdullah Shabani" Mitrovicë; Mirënjohje nga Komuna e Mitrovicës; Procesverbal datës 07.03.2019; Raport i datës 15.11.2012; kopje nga rrjeti elektronik Kosova; Njoftimi i datës 15.05.2019 për përzgjedhjen përfundimtare; Përgjigje në ankesë e datës 01.08.2019; Kërkesë për fillimin e rekrutimit i datës 05.03.2019; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 05.3.2019; Formulari "E" i datës 15.05.2019; Formulari "A" i datës 15.04.2019; Formulari "B" i datës 06.05.2019; Formulari "H" i datës 06.05.2019; Kopje e konkursit i datës 20.03.2019; Autorizimi i datës 15.03.2019; Përshkrimi i detyrave të punës; CV e kandidatit te



interesuar i datës 04.04.2019; Ekstrat nga regjistri i qendrës së regjistrimit i datës 01.04.2019; Certifikatë e Gjykatës Themelore në Mitrovicë të datës 01.04.2019; shkresë e noterizuar; Vërtetimi datës 02.04.2019; Licencë e datë 03.12.2012; Akt vendim i datës 22.03.2011; Referencë i datës 01.04.2019 nga SHFMU "Abdullah Shabani" Mitrovicë; Referencë e vitit 2018; Certifikatë Shëndetësore e datës 02.04.2019; Diplomë Universitare NR.1641 e datë 22.07.2000; Plani zhvillimor i shkollës 2018/2021; CV e kandidatit [ ] Certifikatë e datës 02.04.2019 e Gjykatës Themelore në Mitrovicë; Certifikatë e datës 01.06.2018 "Zhvillimi i kapaciteteve në udhëheqje në arsim "; Licencë e datë 03.12.2012; Referencë e datës 28.05.2018; Vërtetim i datës 03.04.2019 me CV; Diplomë Universitare NR.481 e datë 15.09.2010.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit [ ] është e pa bazuar, sepse

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se në konkursin e shpallur të datës 15.11.2018 nga Komuna e Mitrovicës, për pozitën Drejtor i SHFMU "Abdullah Shabani", kriteret e konkursit kanë qenë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të ketë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240ECTS/4 vite të shkollimit universitar ),
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit ose të jetë në procedurë të licencimit,
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit ,
- Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën Drejtor i SHFMU "Abdullah Shabani" në Komunë të Mitrovicës, i cili pretendon që të anulohet përzgjedhja e kandidatit [ ] sepse janë shkelur kriteret e konkursit, duke pretenduar që të obligohet Komuna e Mitrovicë ta kthejë në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësit nga marrëdhënia e punës, si kandidat i suksesshëm, në pozitë Drejtor i SHFMU "Abdullah Shabani".

Kolegji nga shqyrtimi dhe vendosjen e ankesave bazuar në shkresat e lëndës gjen se: proceduara rekrutimit sipas Konkursit të datës 20.03.2019 për pozitën Drejtor i SHFMU "Abdullah Shabani", është përfunduar brenda 45 ditëve ashtu siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 6 të Udhëzimit Administrativ të MASHT Nr.08/2014, siç përcaktohet se: *Informimi i kandidatëve për rezultatet e konkursit të shpallur bëhet më së voni 45 ditë pas mbylljes së konkursit*".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni i rekrutimit në Komunën e Mitrovicës, ka bërë shkeljen e kriterëve të konkursit me rastin e përzgjedhjes së kandidatit [ ] të cilat pretendime janë të pa qëndrueshme sepse procedura e rekrutimit për pozitë Drejtor i SHFMU "Abdullah Shabani", në Komunën e Mitrovicës, është zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues. Pashtu Kolegji, duke u bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se kandidati i përzgjedhur [ ] me datë 07.07.2010 ka përfunduar studimet themelore në Universitetin e Prishtinës Fakultetin e Edukimit me titullin - Baçelor i Historisë -Edukim Qytetar, gjithsej 240 pikë ECTS, posedon Licencë të mësimdhënësit të karrierës me numër 100002993 prej datës 03.12.2012 deri më datën 03.12.2017 të lëshuar nga Ministria Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Certifikatën e datës 01.06.2018 për përfundimin me



sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional, lëshuar në qershor 2018, nga GIZ dhe Ministria Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe Vërtetimin nr.11/2019 të datës 03.04.2019 të lëshuar nga SHFMU "Bislim Imeri", Këqij i madh në Mitrovicë, me të cilin konfirmohet se punon në këtë shkollë si mësimdhënës i lëndës së Edukatë qytetare prej datës 01.09.2011 e tutje, që i bije afër 8 vite pa ndërprerje, andaj lidhur me provat e lëndës është konstatuar se kandidati i përzgjedhur i ka plotësuar kriteret e konkursit, të përcaktuar me dispozitat e nenit 3 paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, ku përcaktohet se : *"Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesionale për udhëheqje , administrim ose menaxhim.*

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në Formularin "B" për pozitën Drejtor i SHFMU "Abdullah Shabani", në Komunën e Mitrovicës, është konstatuar se kanë aplikuar gjashtë (6) kandidatë, të cilët i kanë plotësuar kriteret e konkursit ashtu siç kërkohet në konkurs dhe që të gjithë kandidatët sa i përket përgatitjes profesionale në mënyrë formal-juridike i kanë plotësuar kushtet e konkursit të përcaktuar me nenin 3 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, ku përcaktohet se: *"Kandidatët e interesuar për të konkurruar në vendin e drejtorit/zëvendës drejtorit duhet t'i plotësojnë këto kushte": 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës; 1.2. Të ketë të kryer së paku arsimin Universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësve sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjor".*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se komisioni përzgjedhës me rastin e vlerësimit të ankuesit dhe kandidatit të përzgjedhur ka vepruar në pajtim me nenin 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, në bazë të formularëve të vlerësimit Formularit "A" dhe formularin "H", të cilët janë të nënshkruara nga komisioni përzgjedhës, siç e përcaktojnë dispozitat ligjore të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Mitrovicës, me datë 26.06.2019 ka nxjerrje Vendimin me numër protokolli 01-111/01-0045654-2/19, me të cilin ka refuzuar ankesën si të pa bazuar, duke konstatuar gjendjen faktike dhe bazën juridike se gjatë procesit nuk ka pasur shkelje të dispozitave ligjore, i cili ka vepruar në pajtim me kompetencën e tij të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, duke vendosur në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave dhe Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kështu që, Kolegji për shqyrtimin e ankesës bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe pas analizimit të gjitha provave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.Nr. 1187/2021.**

Zylye Millaku-Gojnovci

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar / Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit Haki Shyti
- Gjykatës Themelore-Prishtinë, Gjyqtarit Ramadan Bardiqi
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës;
- Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Mitrovicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së .